



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 4252 prot.

Ballsh më, 30. 08.2024

VENDIM

Nr. 40 Datë 28/08/2024

**“PËR MOS MIRATIMIN E PROJEKT VENDIMIT NR. 28, DATË 22.08.2024 “PËR
DHËNIE TË TITULLIT QYTETAR NDERI PËR Z. ÇELO BORAJ”**

Në bazë të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit 139/2015, neni 54, pika m “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit nr. 112/2013, neni 15 “Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, shkresës me nr. 539 prot., datë 05.02.2024 “Kërkesë / Propozim për dhënie titull qytetar nderi” të Shoqatës Patriotike Kulturore Mallakastra, shkresës me nr. 1309/1 prot., datë 26.04.2024 “Kërkesë për informacion mbi pastërtinë e figurës”, drejtuar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentin e ish Sigurimit të Shtetit”, shkresës me nr. 710/3 prot., datë 17.05.2024 “Informim mbi rezultatin e verifikimit të pastërtisë për kandidatin e propozuar për marrjen e titullit të nderit”, relacionit me nr. 4141 prot., datë 21.08.2024 të Komisionit këshillimor për dhënien e titujve të nderit, ngritur me Urdhërin e Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër nr. 126, datë 16.04.2024, procesverbalit të mbledhjes së datës 28.08.2024

VENDOSI

- I- Mos miratimin e projekt vendimit me nr.28, datë 22.08.2024 “Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi”, Çelo Ramadan Boraj”.

KRYETAR

Nexhmë Sulaj

